

UDHËRRËFYES

MËSOVET

Për mësuesit


SITË PËRDORËSH PLATFORMËN
PËR ZHVILLIMIN E MËSIMIT NË
KLASË



MësoVET dhe mësimi i kombinuar

Të mësuarit e kombinuar aplikon avantazhet e mësimdhënies online dhe mësimit ballë për ballë, për të arritur rezultate më të larta në mësimdhënie krahasuar me mësimin tradicional. Të mësuarit në këtë mënyrë së pari ka nevojë për një mjedis virtual të të mësuarit. MësoVET përmbush një lamishmëri funksionesh dhe ka shumë merita në mbështetjen e të mësuarit të kombinuar që nuk zotërohen nga platforma të tjera online si G-Classroom.

Në mësimdhënie, mësuesit mund të zgjedhin stile të ndryshme në përputhje me objektivat e tyre të mësimdhënies dhe përmbajtjen e tyre mësimore, por qëllimi i tyre përfundimtar është të përmirësojnë me efektivitet të nxënit të nxënësve. Ka përmbajtje mësimore që kanë nevojë për mësim ballë për ballë, ka përmbajtje të tjera që adoptojnë të mësuarit në internet dhe ka shumë të tjera që lehtësisht mund të përcillen duke kombinuar këto dy metoda. Përdorimi i platformës MësoVET në klasë, përveç materialeve mësimore, ofron mënyra të ndryshme shkëmbimi midis mësuesve dhe nxënësve, forcon ndërveprimin midis nxënësve, i jep shtysë iniciativës dhe aktivitetit të nxënësve. Pra, MësoVET në klasë ndikon në rritjen e cilësisë dhe nivelit të mësimdhënies.



MësoVET jo vetëm që mund t'u sigurojë nxënësve një mjedis të mësuarit në mënyrë të pavarur duke përdorur burimet që ofron, por gjithashtu ofron një platformë për diskutim, ndërveprim, vlerësim dhe i nxit nxënësit të marrin pjesë në të mësuarit në grup. Gjatë procesit mësimor në klasë, mësuesit do të drejtojnë dhe orientojnë të gjithë aktivitetin, ndërsa nxënësit mund të marrin pjesë aktivisht në forume, detyra e diskutime. Mjedisi që MësoVET krijon për nxënësit i ndihmon ata në interpretimin e njohurive dhe nxit kreativitetin e tyre.

Si të organizosh procesin mësimor në klasë duke përdorur MësoVET?

Në çdo klasë, ka nxënës që gjithmonë kanë ngritur dorën për të marrë pjesë në mësim dhe ka nxënës që hezitojnë të angazhohen. Mësuesi duhet të përpiqet ti përfshijë të gjithë në aktivitetet e klasës dhe të shmangë dëgjimin pasiv. Për të realizuar këtë, secili nxënës duhet të bindet që informacioni që ai përfiton duke

dëgjuar mësimin është mjaftueshëm i rëndësishëm dhe e meriton përkushtimin e tij. Kështu, më vonë nxënësi motivohet të merret dhe në shtëpi me materialin dhe të përgatitet për provimet.

Nxënësi mund t'i bëjë të gjitha këto, por vetëm më ndihmën e mësuesit. Mësuesi mund të përdorë MësoVET për të nxitur pjesëmarrjen në mësim dhe bashkëveprimin midis nxënësve në klasë duke thyer rutinën e zakonshme të të mësuarit tradicional.

Hapat:

Përcaktoni planin e orës mësimore dhe objektivat e temës mësimore ashtu sic bëni zakonisht në përshtatje me lëndën që mbulonit dhe temave të caktuara të lëndës. Supozojmë se ndiqni një organizim të tillë:

- Kontrolli i njohurive mbi temën pararendëse
- Prezantimi i temës së ditës
- Shpjegimi i mësimit
- Trajtimi i çështjeve dhe nëncështjeve
- Ushtrime dhe veprimtari praktike
- Detyra shtëpie

Sigurisht që secili mësues ose mund ti kryejë të gjitha veprimtaritë e listuara brenda një ore mësimore, ose vetëm disa prej tyre ose mund të kryejë dhe veprimtari të tjera që nuk janë të listuara më lart. Pas përcaktimit të aktivitetit të ditës mund të hyjni në MësoVET dhe shtoni aktivitetet që dëshironi ose mund ta bëni gjatë orës mësimore.


Hapi i radhës është identifikimi në platformë i juaji dhe i secilit nxënës me llogarinë e vet dhe aksesimi i kursit.

Para se të shpjegoni temën e re mund ta stimuloni kureshtjen e nxënësve me një stil prezantimi frymëzues dhe energjik, me aktivitete dhe diskutime që e ndihmojnë nxënësin të arrijë pak më shumë se aftësitë e tij aktuale. Mund të shfaqni një video nga MësoVET apo një kuriozitet dhe të nxisni diskutim lidhur me to.

TEMA 1: GADISHULLI I BALLKANIT – POZITA GJEOGRAFIKE DHE KUSHTET NATYRORE

Në fund të temës, nxënësi:

- Prezanton në terma të përgjithshëm Rajonin e Ballkanit, duke përcaktuar pozitën e Ballkanit në hartën e Evropës.
- Përshkruan veçoritë natyrore të gadishullit, relievin, klimën, hidrografinë, botën bimore e shtazore, duke evidentuar elementet kryesore në hartë.
- Evidenton elemente të spikatura të ofertës turistike gjeografiko-natyrore të Ballkanit.



Lexim:

Orient Express, treni ikonë i udhëtimeve për më shumë se një shekull.



Më 5 qershor 1883, treni Orient Express për herë të parë u nis nga Parisi për në Vjenë. Zyrtarisht mori këtë emër në vitin 1891. Në vitet 1930, Orient Express arriti kulmin e lulëzimit. Punonte në tri linja paralele:



Orient Express, Simpon Orient Express dhe Arlberg Orient Express. Gjatë kësaj kohe, Orient Express u bë simbol i komoditetit dhe i luksit. Familjet mbretërore, fjsnikëria, diplomatët, njerëzit e biznesit dhe borjzeria ishin klientët e tij. Ai përshkronte Evropën nga njëri skaj në tjetrin, nga Londra në Stamboll.



Mund të përdorni dhe teknika të tjera për të entuziazmuar nxënësin të dijë më shumë rreth temës. Mund ta bëni këtë përmes një ushtrimi interaktiv. Mund të përdorni pafund të tilla. Për shembull nxënësit mund të plotësojnë me ndihmën tuaj një fjalëkryq për tu njohur me konceptet kryesore të temës apo tu jepet një imazh që mund të përfaqësojë një vegël, një qytet, një grafik, etj., dhe nxënësi të gjejë emrin përkatës apo një lojë të vogël e të shpejtë për ti përfshirë të gjithë në temë.



Këto ushtrime mund ti përdorni edhe për të testuar njohuritë mbi temën pararendëse. Mund të bëni edhe një kuic me limit kohe 5 minuta për mësimin e orës së kaluar. Nxënësi mund ta kryejë në klasë dhe të marrë rezultatin menjëherë pasi e dorëzon kuicin. Ndërkohu ju mund ti shikoni rezultatet e gjithësecilit me qetësi më vonë.

Mund të vijoni të shpjegoni çështjet e temës duke mbajtur monitorin në MësoVET dhe duke naviguar nga faqja në faqe për të shpjeguar mësimin. Ndërkohë nxënësit mbajnë shënimet e tyre dhe në të njëjtën kohë kuptojnë edhe ku ti gjejnë materialet për ti mësuar më pas vetë në shtëpi. Prania e imazheve me ngjyra apo diku edhe videot mund tu tërheqin vëmendjen nxënësve dhe ti shtyjë të përqendrohen në mësim dhe të fiksojnë koncepte apo imazhe më lehtë.

Për të nxitur angazhimin dhe bashkëpunimin mund të hapni në moment një forum, ku të vendosni një temë të caktuar e të kërkonti që gjithsecili të shkruajë mbi mendimin e tij, të kundërshtojë mendimin e tjetrit, të mbrojë idenë e vet dhe të nxitet kështu një diskutim midis nxënësve. Për shembull në rastin e letërsisë mund të kërkonti që secili prej nxënësve të shkruajë në forum mbi personazhin e tij të preferuar në një vepër të caktuar. Një tjetër mundësi mund të

jetë, krijimi i një problemi të cfarëdolloj fushe apo lënde dhe secilit nxënës ti kërkohet të shtrojë në forum zgjidhjen që ai mendon se është e duhura. Pse duhet ta shkruajë nxënësi në forum këtë dhe jo në fletore? Është më mirë ta shkruajë në forum, në mënyrë që në shtëpi të hyjë në platformë për të parë zgjidhjet që i kanë dhënë shokët dhe të vazhdojnë diskutimin edhe nga shtëpia. Kështu ai njihet me mënyra të tjera zgjidhjeje dhe mund të flasë e të argumentojë pse zgjidhja e tij është më e mira ashtu sic diskuton në grupet e chatit në rrjetet sociale me shokët e tij.

Vlerëso, argumento, gjyko

Shkruani argumentat tuaja lidhur me temat që paraqiten në forum. Klikoni mbi secilin nga temat dhe jepni argumentat dhe vlerësimin tuaj lidhur me pyetjen që shtrohet. Mos harroni ti postoni ato!

Shto një temë të re diskutimi

Diskutim	Nisur nga	Përgjigjet	Postimi i fundit	Krijuar ↓
☆ Ndani eksperiencat:	MesoVet Support	0	MesoVet Support Sht , 10 Pri 2021, 23:38	Sht , 10 Pri 2021, 23:38
☆ Vlereso dhe argumento:	MesoVet Support	0	MesoVet Support Sht , 10 Pri 2021, 23:37	Sht , 10 Pri 2021, 23:37
☆ Si e kuptoni shprehjen :	MesoVet Support	0	MesoVet Support Sht , 10 Pri 2021, 23:37	Sht , 10 Pri 2021, 23:37

Forumet mund të përdoren për shumë qëllime si shqyrtimi i materialit para një detyre ose provimi apo reflektimi mbi materialin që nxënësit kanë lexuar ose punuar jashtë klase. Diskutimet në MësoVET mund t'i nxisin ata të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të artikulojnë përmbajtjen e kursit me fjalët e tyre. Dinamika interaktive e forumit mund t'i ndihmojë nxënësit të mësojnë dhe t'i motivojë ata të kryejnë detyrat e shtëpisë dhe të përgatiten për orën mësimore të radhës.

Tutorial për forumin në MësoVET:
<https://mesovet.al/mod/hvp/view.php?id=4601>

Një tjetër mënyrë që MësoVET mundëson është krijimi i faqeve wiki. Wiki ju jep mundësinë të krijoni portofole grupi dhe portofole individuale për nxënësit tuaj. Pra një wiki mund të jetë bashkëpunues ku të gjithë nxënësit mund ta modifikojnë atë, ose individual, ku secili ka wiki-n e vet, të cilin vetëm ai mund ta redaktojë. MësoVET ruan historikun e secilës faqe në wiki, duke renditur redaktimet e bëra nga secili pjesëmarrës, kështu mësuesi mund të shohë të gjithë ata që kanë shtuar apo redaktuar faqen. Si ndihmon kjo në angazhimin e nxënësve në klasë? Si funksionon Wiki?

Mjafton që Wiki të shtohet si aktivitet në kurs dhe më pas të hapet një faqe bashkëpunuese nën emrin Portofoli im. Pas kësaj mësuesi hap nga një portofol për secilin nxënës duke vendosur brenda kllapave katrore emrin e secilit nxënës sic paraqitet në figurë. Nëse e ndani klasën në grupe atëherë nxënësit mund të zgjedhin një emër që duan për grupin e tyre dhe mund të vendosni brenda kllapave emrin e grupit. Kështu secili nxënës shkruan dhe ngarkon materiale në grupin e vet. Pasi klikoni mbi Ruaj dhe shfaq atëherë do shfaqet portofoli i klasës me emrin e secilit nxënës.

Redaktimi i kesaj faqeje 'Portofoli i perbashket'

Formati HTML

1 A B I ☰ ☰ 🔗 🔗 🖼️ 📄 🗣️ 📹 📷

[[Albina Bardhi]]
 [[Rafaela Kolaj]]
 [[Fjorela Pahunii]]
 [[Irena Maiko]]

Portofoli im

Kliko mbi emrin tend dhe shto materialet qe ke pergatitur ne faqen tende

Shiko Redakto Komentet Historiku Harte Skedaret

Portofoli i perbashket

Albina Bardhi
Rafaela Kolaj
Fjorela Pahunii
Irena Majko

◀ Njoftimet

Kalo tek...

Kur nxënësit hapin portofolin, do u shfaqet menuja si në figurë. Mjafton të klikojë mbi emrin e vet që të ketë mundësi ta redaktojë. Mundësitë e redaktimit janë të shumta. Nxënësi mund të ngarkojë dosje, punime në word, pdf apo powerpoint. Mund të ngarkojë video dhe foto apo të shkruajë e ndërtojë tabela.

Kliko mbi emrin tend dhe shto materialet qe ke pergatitur ne faqen tende


Shiko Redakto Komentet Historiku Harte Skedaret Administrimi

Albina Bardhi

Qarku elektrik qe une kam punuar

Materialet qe nevojiten:

- Burimi elektrik i cili eshte shnderruesi i nje energjie (mekanike, kimike, te drites) ne energji elektrike. Brenda burimit elektrik ulet kalojne ne pika me potencial me te larte. (ne rastin tim jane perdorur baterite)
- Shpenzuesi eshte shnderruesi energjise elektrike ne energji te llojit tjetër. (ne rastin tim jane llapat)
- Percjellesit e elektricitet, ne te cilet kalon rryma elektrike. (telat)
- Celesi, i cili eshte pergjegjesi i tejçimit ose jo te rrymes.



Një rast i përdorimit tregohet në figurë. Nxënësi ka punuar mbi qarkun elektrik dhe ka përshkruar mjetet dhe punën që ka bërë për ta ndërtuar. Pas kësaj ka bërë foto dhe ka ngarkuar foton në platformë.

Mësuesi ka mundësi të shohë punën e nxënësit, ta redaktojë nëse e shikon të nevojshme dhe të lërë komentet e veta për punën e nxënësit. Nga ana tjetër nxënësit kanë mundësi të shohin punët e shokëve dhe të komentojnë për to.

Ata mund të ngarkojnë materiale ne wikin e tyre kur të duan dhe ta pasurojnë e ruajnë punën e tyre si dhe ta ndajnë atë me të tjerët.

Mësuesi mund të përdorë dhe mënyra të tjera për ta integruar wikin në klasë. Ai mund të hapë nga një wiki për ceshtje të ndryshme të temës së ditës dhe të caktojë nga një ceshtje për një grup prej 4 ose 5 vetash. Kështu nxënësit mund ta aksesojnë në klasë wikin e tyre dhe vendosin aty detyrën që u cakton mësuesi. Secili nxënës plotëson tjetrin derisa arrijnë në punën finale që mund të jetë një përmbledhje e ceshtjes, një ushtrim për tu zgjidhur apo një argumentim mbi një ceshtje të caktuar. Nxënësit mund të ngarkojnë edhe foto direkt nga google apo video nga youtube përmes linkut dhe MësoVET e konverton automatikisht në imazh apo video. Kështu nxënësit mund ta plotësojnë veprimatrinë e tyre edhe nga shtëpia dhe të mësojnë edhe nga punimet e shokëve.

Përvec kësaj mund të krijoni ushtrime të ndryshme për tu punuar në mënyrë të pavarur nga nxënësi nën mbikëqyrjen tuaj.

Ushtrime dhe veprimtari praktike

Gjurmët e para të popullimit të Ballkanit i përkasin periudhës së lulëzimit të Perandorisë Romake.

True False

Vendos në rend kronologjik secilin nga perandoritë apo shtetet që formësuan historinë e Ballkanit në shekuj.

-
-
-
-
-
-

Përcaktoni pozicionin gjeografik dhe shtetet që e përbëjnë rajonin e Ballkanit.

Plotëso

Relievi mbizotëron në gadishullin e Ballkanit.

Në Ballkan gjenden % e listës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO.

është vendi ballkanik me të ardhurat vjetore më të larta për frymë.

është dega kryesore e ekonomisë në shtetet Ballkanit Perëndimor.

është shteti ballkanik me vijën bregdetare më të gjatë.

Kontrolli i ushtrimeve kryhet automatikisht nga platforma. Rrjedhimisht, kjo është një mënyrë shumë e mirë që të gjithë nxënësit të aktivizohen dhe është dhe një mënyrë përgatitje për provim. Në të mësuarit tradicional, mësuesi nuk do kishte kohë të kontrollonte detyrën në klasë të secilit nxënës, ndërsa në MësoVET mësuesi nuk ka pse e bën këtë. Ai mjafton të krijojë ushtrimin njëherë dhe ushtrimin mund ta plotësojnë të gjithë dhe të gjithëve do u kontrollohet në moment. Mësuesi do jetë aty për cdo pyetje që mund tu lindë nxënësve gjatë kryerjes së ushtrimeve dhe po ashtu mësuesi mund të marrë dhe reagimet e tyre. Mund të shohë se si nxënësit pefeorjnë të punojnë: në grup, individualisht, kanë dëshirë të mësojnë duke u zbavitur, mësojnë më mirë vizualisht, preferojnë të dëgjojnë, etj.

Mundeni gjithashtu në fund të caktoni një detyrë dhe të përcaktoni një afat dorëzimi në MësoVET. Nga aty më pas mund të kontrolloni dhe ti përcillni vlerësimin nxënësit po nëpërmjet platformës.

Në fund të orës mësimore nxënësi do dijë ku të drejtohet për të mësuar për herën tjetër dhe do dalë nga klasa me një dicka sado të vogël për ta mbajtur mend.

Këshilla: Çfarë duhet të bësh si mësues dhe çfarë jo?

✓ Inkurajo nxënësit të mësojnë së bashku në MësoVET

MësoVET nuk është vetëm për materialet apo burimet mësimore. MësoVET është ndërtuar dhe dizenuar me një filozofi. Nxitini nxënësit tuaj të mësojnë së bashku në MësoVET, jo si një libër që është postuar në internet, por si anëtarë të një komuniteti të vazhdueshëm, aktiv të të mësuarit.

Kjo do të thotë që puna juaj si 'mësues' mund të ndryshojë nga të qenit 'burim i njohurive' në të qenit një model i kulturës së klasës, duke adresuar nevojat e tyre të të mësuarit dhe duke moderuar diskutimet dhe aktivitetet në një mënyrë që kolektivisht i drejton nxënësit drejt të nxënimit.

✓ Tregoju nxënësve që ti i monitoron

Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë se ju mund të monitoroni se ku shkojnë, çfarë bëjnë dhe sa kohë shpenzojnë në faqen e kursit në MësoVET. Tregoju ata një shembull të listave të monitorimit dhe vini në dukje angazhimin e gjithësecilit.

✓ Nxiti nxënësit të jenë të vetëdijshëm për sigurinë

Nxënësit duhet të jenë shumë të kujdesshëm në lidhje me postimin e informacionit personal në çdo faqe në internet, madje edhe në MësoVET. Ata gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se duke u përfshirë në komunikim me shokët e tjerë të klasës në platformë nuk tolerohen sjelljet apo komentet e papërshtashme.

✓ Krijo dhe përfshij nxënësit në forume sa më shpesh

Shpjegoju nxënësve që ndërveprimet në forum jo vetëm e njohin atë me opinione dhe punë të nxënësve të tjerë, por edhe e mësojnë të jetë më kritik ndaj qasjes së dikujt. Inkurajoni ata të përdorin postimet e forumit si një mundësi për të mësuar dhe praktikuar aftësi të mira shkrimi.

✓ Mos prisni që MësoVET të bëjë punën tuaj

Ndodh që edhe nxënësit e përkushtuar e sistematikë të demotivohen. Një mësues duhet të kuptojë jo vetëm si nxënësit mësojnë, por edhe mundësitë që ofron teknologjia për të përcjellë njohuri të nxënësit. Nxënësi nuk do entuziazmohet të përdorë MësoVET nëse ti si mësues nuk arrin ti tregosh apo vërtetosh benefitet e shumta që MësoVET i ofron dhe nëse nuk ja bën të bukur eksperiencën e të mësuarit me opsionet e shumta që MësoVET të mundëson.

✓ Mos ki frikë të eksperimentosh

MësoVET të jep mundësinë të krijosh grupet e tua dhe të postosh detyra e materiale vetëm për to. Provo të krijosh kuice të vogla 5 minutëshe cdo javë për grupin tënd. Kështu nxënësit hynë në platformë dhe për të kontrolluar njohuritë në kuicin që ke krijuar, do hapin burimet mësimore dhe do studiojnë. Krijoni detyra dhe hapni diskutime apo dhoma chati derisa të gjeni mënyrën që ju përshatet më shumë juve dhe lëndës mësimore.